**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**
***Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor***

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca
Office of the Chief State Prosecutor

# BULETINI MUJOR

## BULETINI I PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**
***Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor***

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca
Office of the Chief State Prosecutor

# Buletini i Prokurorit të Shtetit

# Nëntor 2020

**Përmbajtja**

FJALA HYRËSE E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT..... 5

Aktivitetet e Prokurorit të Shtetit, nëntor 2020 ..... 6

## FJALA HYRËSE E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me qëllim të rritjes së transparencës së institucionit të Prokurorit të Shtetit ka përgatitur dhe publikuar Buletinin njëmujor.

Opinioni publik do të ketë mundësi të informohet edhe përmes këtij Buletini për aktivitetet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Si Kryeprokuror i Shtetit jam i përkushtuar të vazhdojmë punën dhe angazhimin që institucioni i Prokurorit të Shtetit të realizojë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë, të cilat burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera në fuqi.

Prokurori i Shtetit përmes publikimit të Buletinit njëmujor ka për qëllim që ta mbajë të informuar opinionin e gjerë publik, duke përfshirë qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile për punën e gjithë institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Ju faleminderit!
Aleksandër Lumezi
Kryeprokuror i Shtetit

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

### Diskutohet zbatimi i aktiviteteve të projektit EUKOJUST

**Prishtinë, 5 nëntor 2020** – Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, së bashku me Kryesuesin e Këshillit Prokurorial (KPK), Bahri Hyseni, ka pritur në takim ekspertët e Projektit EUKOJUST, Cristian Nicoara dhe Volkman Theobald.

Temë diskutimi në këtë takim ndërmjet bartësve të sistemit prokrurorial dhe ekspertëve ishte fillimi i zbatimi i projektit EUKOJUST, projekt ky, që ka për qëllim reformimin e sistemit të drejtësisë në linjë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Kryeprokurori Lumezi dhe Kryesuesi Hyseni kanë diskutuar së bashku me ekspertët edhe për objektivat specifike që ndërlidhen me sistemin prokurorial siç janë: fuqizimi i llogaridhënies, transparencës, profesionalizmit, kualitetit, efektivitetit, pavarësisë dhe paanësisë.

Ky projekt, përmes aktiviteteve të tij, synon të arrijë rezultate në

fuqizimin e kapaciteteve të KPK-së dhe prokurorive në çështje të ndryshme, si në planifikimin strategjik, krijimin e databazës elektronike për regjistrimin e rasteve disiplinore, fuqizimin e zhvillimit të procedurave disiplinore, fuqizimin e kapaciteteve të komisionit në proceset e përformancës, specializimin e prokurorëve, zhvillimin e mëtutjeshëm të administrimit, regjistrimit, sistematizimit dhe ruajtjes së lëndëve në sistemin e arkivimin, përkrahje në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave sa më të sakta, si dhe në përkrahjen e hartimit të akteve nënligjore të sistemit prokurorial.

Po ashtu, synohet që të përmirësohen edhe procedurat për zgjedhjen dhe avancimin e prokurorëve, koordinimin e sistemeve të teknologjisë informative, përkatësisht konsolidimin e sistemit SMIL, si dhe fuqizimin e ndërlidhjes së infrastrukturës së teknologjisë informative në sektorin e drejtësisë.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, kanë shprehur gatishmërinë dhe përkushtimin e tyre institucional në zbatimin e plotë të këtij projekti, i cili do të jetë në funksion të fuqizimit dhe përmirësimit të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Projekti EUKOJUST, i cili mbështet sistemin e drejtësisë në Kosovë, financohet nga Bashkimi Evropian, dhe implementohet nga konsorciumi mes IRZ (Gjermani), CILC (Holandë) dhe Ministria e Drejtësisë e Kroacisë. Projekti ka filluar implementimin më 1 tetor 2020 dhe do të zgjasë 40 muaj.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

### Kërkohet paraburgim ndaj pesë personave për vrasje e rëndë në tentativë

**Prishtinë, 5 nëntor 2020** – Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarve G.K., A.K., F.K., B.K., dhe Sh.K., me dyshimin se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Vrasje e rëndë në tentativë", nga neni 173 paragrafi 1 pika 1.9 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Rasti ka të bëjë me përleshjen e cila ka ndodhur në Fushë Kosovë, më 3 nëntor 2020, si pasojë e shqiptimit të një tikete kundërvajtjeje, janë sulmuar fizikisht me mjete të forta (shipka të metalit) dy zyrtarë policor nga shtatë persona të dyshuar. Nga kjo përleshje pesë persona kanë marrë lëndime trupore, prej tyre dy zyrtarë, të cilët kanë pranuar trajtim mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Të dyshuarit, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

# NËNTOR 2020

## Arrestohen nëntë (9) persona të dyshuar për krime kibernetike dhe mashtrim

**Prishtinë, 12 nëntor 2020** – Me urdhër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, përkatësisht Sektori për Hetime të Krimeve Kibernetike, si dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar (Gjermaninë), pas hetimeve disamujore dhe shkëmbimit të informacioneve me Autoritetet Gjermane, gjatë ditës janë kontrolluar 13 lokacione në Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Vushtrri, ku janë arrestuar nëntë (9) persona të dyshimtë (disa prej tyre në flagrancë).

Bazuar në dyshimet e mbledhura gjatë hetimeve, është ardhur në përfundim se ekziston dyshimi i bazuar që të dyshuarit me inicialet A.K., K.B., F.G., A.S., H.K., L.B., L.B., E.Z dhe H.B., në bashkëveprim me njëri tjetrin, me qëllim të përfitimit material në mënyrë të kundërligjshme, përmes sistemeve kompjuterike kanë komunikuar përmes e-maileve dhe telefonit me viktimat, kryesisht shtetas të huaj, të cilët i kanë mashtruar dhe më pas detyruar që përmes institucioneve mikro-financiare që operojnë në Republikën e Kosovës, të ju dërgojnë mjete financiare (para) në vlera të ndryshme.

Po ashtu, gjatë këtij operacioni janë sekuestruar, të gjitha provat relevante të cilat janë përdorur për kryerjen e veprave penale

Gjithashtu, në cilësi të provave janë sekuestruar:

- 35 (tridhjetë e pesë) shtëpiza kompjuteri;
- 31 (tridhjetë e një) monitorë kompjuteri;
- 4 (katër) llaptopa;
- 1 (një) veturë Audi A8;
- 15 (pesëmbëdhjetë) telefona mobil;

- 5 (pesë) USB;
- 53 (pesëdhjetë e tre) CD;
- 2 (dy) revole me gaz;
- 52 (pesëdhjetë e dy) copë municion;
- Dokumentacion i ndryshëm (fletore, dorëshkrime etj.).

Me urdhër të Prokurorit të Prokurorit të Prokurorisë Speciale, tetë (8) të dyshuarit me inicialet A.K., K.B., F.G., A.S., H.K., L.B., L.B., E.Z janë dërguar në mbajtje, ndërsa, e dyshuara me inicialet H.B., është liruar në procedurë të rregullt.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT NËNTOR 2020

## Prokuroria Speciale ka bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit ndaj tetë të dyshuarve

**Prishtinë, 13 nëntor 2020** – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka bërë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti Special, në afat prej 30 ditësh, ndaj tetë (8) të dyshuarve me inicialet A.K., K.B., F.G., A.S., H.K., L.B., L.B., E.Z, për veprat penale “Mashtrimi” nga neni 323 paragrafi 4 lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe “Pjesëmarrja apo organizimi i grupit kriminal të organizuar” nga neni 277 i KPK-së.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

### Dy të ndaluar në dy bastisjet në Zveçan dhe Vushtrri ku u gjet sasi e madhe municioni

**Mitrovicë, 13 nëntor 2020** – Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ndaluar dy (2) persona, në dy bastisjet e zhvilluara në Zveçan dhe Vushtrri, ku u gjet municion i pushkës së gjuetisë.

Gjatë bastisjes në Zveçan është konfiskuar sasi e madhe municioni e pushkës së gjuetisë, si dhe është ndaluar një (1) person, për shkak të veprave penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse" nga neni 364 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Ndërkaq, gjatë bastisjes së një veturë në Vushtrri janë gjetur dhe konfiskuar njëmijedyqind (1200) fishekë të pushkës së gjuetisë, si dhe është ndaluar personi të cilit i janë gjetur fishekët, për shkak të veprave penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse" nga neni 364 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Me vendim të prokurorit të Departamentit për Krime të Rënda dy (2) të ndaluarit janë dërguar në mbajtje për dyzetetetë (48) orë.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

### SQARIM PËR MEDIA

**Prishtinë, 16 nëntor 2020** – Prokuroria Themelore në Prishtinë, për hir të informimit korrekt njofton opinionin lidhur me shkrimet se është ngritur aktakuzë ndaj personit me inicialet A.B., pas shfaqjes së veprës artistike para objektit të Qeverisë, duke ju njoftuar se i njëjti vetëm është intervistuar nga Policia e Kosovës, në të njëjtën kohë, sqarojmë opinionin se Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk ka ngritur aktakuzë ndaj të njëjtit e as nuk është ndaluar me urdhër të prokurorit kujdestar të kësaj prokurorie.

Personi me inicialet A.B., pas intervistimit është liruar në procedurë të rregullt.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

### Ngrihet aktakuzë për shpëlarje të parave

**Prishtinë, 18 nëntor 2020** – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kundër të pandehurve me iniciale B.T, Q.T, A.T dhe J.T, shtetas të Republikës së Kosovës.

Aktakuza është ngritur për shkak se është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë, se të pandehurit  në bashkëveprim kanë kryer veprën penale "Shpëlarja e parave", nga neni 302 të KPRK-së dhe ligjit nr. 05/L96 neni 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Në aktakuzë është propozuar edhe konfiskimi i pasurisë se paluajtshme, pronë e të pandehurve, e cila gjatë fazës se hetimeve ka rezultuar të jetë pasuri e fituar me vepër penale.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT NËNTOR 2020

**Për dhjetë muaj, Prokuroria e Pejës ka parashtruar 107 kërkesa për sekuestrim**

**Pejë, 23 tetor 2020** - Prokuroria Themelore në Pejë njofton opinionin publik se në periudhën kohore janar-tetor të këtij vitit ka bërë gjithsej 107 (njëqind e shtatë) kërkesa për sekuestrimin e mjeteve, të cilat dyshohen të jenë përdorur apo përfituar përmes veprave të ndryshme penale.

Nga muaji janar i këtij vitit gjer në muajin tetor, kjo prokurori ka parashtruar në gjykatat kompetente kërkesa për sekuestrimin e 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) mjeteve të transportit, ndër to: 33 (tridhjetë e tri) vetura të llojeve të ndryshme, 17 (shtatëmbëdhjetë) mjete transporti (kamionë, ekskavatorë, kombi), 15 (pesëmbëdhjetë) traktorë dhe 11 (njëmbëdhjetë) rimorkio të mjeteve të ndryshme të transportit.

Nga Prokuroria Themelore e Pejës janë kërkuar të sekuestrohen 6250

(gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) kilogramë miell gruri për dhjetë muajt e këtij viti. Po ashtu, edhe pako me cigare të llojeve të ndryshme në vlerën prej 3223 (tre mijë e dyqind e njëzet e tre) eurosh dhe para të gatshme në vlerën prej 2552 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) eurosh.

Në Prokurorinë Themelore të Pejës janë kërkuar të sekuestrohen 167 $m^3$ (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) masë drusore në dhjetë (10) raste të kërkesave për sekuestrim gjatë periudhës kohore janar-tetor të vitit 2020.

Vlen të theksohet se shumica e kërkesave të parashtruara për sekuestrim nga Prokuroria Themelore e Pejës janë aprovuar nga gjykatat.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT NËNTOR 2020

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

**Prishtinë, 29 nëntor 2020** – Prokurori i Shtetit njofton opinionin publik se është duke përcjellë me vëmendje procesin zgjedhor i cili po zhvillohet sot, për kryetarë të dy komunave, në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut.

Që nga ora shtatë e mëngjesit të sotëm, janë të angazhuar prokurorë kujdestarë, të cilët do të përcjellin për së afërmi mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në zgjedhjet lokale, në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut. Prokurorët kujdestarë janë në gjendje gatishmërie që të reagojnë në çdo rast ku ka pengim të procesit të votimit.

Prokurori i Shtetit, me qëllim të parandalimit të çdo shkelje që lidhet me të drejtën e votës, fton qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile, të bashkëpunojnë dhe raportojnë te Policia dhe Prokuroria të gjitha pretendimet për keqpërdorim të votës.

# AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

## NËNTOR 2020

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

**Prishtinë, 29 nëntor 2020** – Prokurori i Shtetit njofton opinionin publik se ka përcjellë me vëmendje procesin zgjedhor i cili është zhvilluar sot, për kryetarë të dy komunave, në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut.

Prokurorët kujdestarë kanë përcjell për së afërmi mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në zgjedhjet lokale, në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut. Prokurorët kohë pas kohe kanë vizituar shumicën e vendvotimeve në këto dy komuna ku janë njoftuar për së afërmi me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Po ashtu, një prokuror kujdestar gjatë gjithë kohës ka qenë prezent në KQZ për tu njoftuar me tërë ecurinë e procesit zgjedhor.

Vlen të theksohet se gjatë ditës së sotshme nuk ka pasur ndonjë rast të evidentuar si vepër penale nga kapitulli i veprave penale kundër të drejtës së votimit, apo që ka mundur të ndikojë në prishjen e procesit zgjedhor, përpos rasteve për të cilat ka njoftuar Prokurori i Shtetit.

PROKURORI I SHTETIT
DRŽAVNI TUŽILAC